



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 nën d) si dhe nenit 40.1 dhe 40.2 nën l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ, Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, si dhe nenit 40 paragrafi 1 dhe 2 nën pikën e fundit të Statutit të Komunës së Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-rë të radhës për vitin 2015 të mbajtur më 30.01.2015 mori këtë:

VENDIM

Për

Miratim të Planit të Punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi për vitin 2015

I

Miratohet Plani i Punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi për vitin 2015.

II

Pjesë përbërëse e vendimit është Plani i Punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Klinës dhe numri i takimeve për vitin 2015.

III

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Klinës dhe 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës sipas Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-768 2015
Klinë, më 30.01.2015



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi